

VENDIM
Nr.788, datë 14.12.2005

PËR PËRCAKTIMIN E AKSIDENTIT NË PUNË OSE PËR SHKAK TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aksident në punë ose për shkak të punës është dëmtimi i menjëhershëm trupor, i ndodhur gjatë kryerjes së punës ose gjatë një procesi, që ka lidhje me punën, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që nuk rrjedh nga sëmundje të përgjithshme, por që sjell paaftësi, të përkohshme ose të përhershme, në punë ose vdekje.

2. Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose për shkak të punës, kur personi i punësuar dëmtohet:

- a) gjatë kryerjes së punës së zakonshme;
- b) gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa urdhër të punëdhënësit, por, për arsye madhore, në interes të punës;
- c) gjatë kreyrejs së një pune tjetër, me porosi të punëdhënësit;
- ç) gjatë kohës së pushimit, në vendin e caktuar ose për vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, para ose pas mbarimit të punës;
- d) gjatë rrugës, në linjën e drejtpërdrejtë, nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësit dhe kur ai është individual.

3. Në çdo rast të një aksidenti në punë ose për shkak të punës, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, duhet të lajmërojë, brenda 3 ditëve, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Në rast të një aksidenti në punë ose për shkak të punës, me pasojë vdekje apo dëmtime të rënda masive, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, pas dhënies së ndihmës së parë, duhet të ruajë provat materiale, për analizën e këtij aksidenti, dhe të lajmërojë, menjëherë, organet e prokurorisë, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Kur aksidenti ka ndodhur gjatë rrugës nga banesa për në punë dhe anasjelltas, procesverbali i mbajtur nga organet e policisë, duhet të bëhet pjesë e dokumentacionit, për përfitimin e pagesës së aksidentit në punë.

6. Aksidenti në punë ose për shkak të punës vërtetohet me procesverbalin e mbajtur në vendin e ngjarjes dhe duhet të nënshkruhet nga punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, si dhe nga inspektori i punës, brenda tri ditëve nga ndodhja e aksidentit.

Forma e procesverbalit dhe udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij përcaktohen nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Për shkeljet sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, punëdhënësi ose personi përgjegjës i ngarkuar prej tij, dënohen sipas kreut VIII “Procedura dhe sanksione” të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar.

8. Vendimi nr.460, datë 22.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për aksidentet në punë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha